Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRISË
MINISTARSTVO ZA TRGOVINU I INDUSTRIJU
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

PROFILI I SEKTORIT TË **INDUSTRISË SË PËRPUNIMIT TË DRURIT**

Mars 2014

PROFIL I SEKTORIT TË INDUSTRISË SË PËRPUNIMIT TË DRURIT

Mars 2014

Mirënjohjet dhe Falenderimet

Ky raport është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës brenda kornizës së angazhimeve përmes projektit "Ndihmë Tregtisë", implementuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

MINISTRY FOR FOREIGN AFFAIRS OF FINLAND

Për realizimin e këtij raporti kontribut i veçant është dhënë nga:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë:
Kabineti i Ministrit
Departamenti i Industrisë
Departamenti i Integrimeve Evropiane dhe Koordinimit të Politikave
Agjencia për Mbështetje të Investimeve dhe Ndërmarrjeve në Kosovë

Anketimi në terren realizuar nga TNS Index Kosova, Agjenci për hulumtime sociale, të mediave dhe marketingut

Kontrolli i Cilësisë:
Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) Kosovë
Njësia për Politika, Hulumtime, Çështje gjinore dhe komunikim
Njësia për Zhvillim Gjithpërfshirës
Projekti "Ndihmë Tregtisë"
Petrit Gashi, Phd – Konsulent i Jashtëm

Autore
Ardiana Gashi

Përkthyes në gjuhën Shqipe:
Hyjnor Jasiqi

Dizajni: "XHAD Studio", Prishtinë
Shtypi: "Grafika Rezniqi" Prishtinë

Si dhe një falenderim i veçantë për të gjithë respodentët e përfshirë në hulumtim.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të pjesëmarrësve dhe të autorëve, dhe në asnjë mënyrë nuk përfaqësojnë qëndrimet zyrtare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Finlandës.

E drejta autoriale © 2014. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përmbajtja

Mirënjohjet dhe Falenderimet 2
Lista e shkurtesave 4

1. Hyrje 5

2. Të dhëna bazike për sektorin e drurit 7
2.1. Shpërndarja e kompanive sipas madhësisë 7
2.2. Shpërndarja rajonale e kompanive në sektor 8
2.3. Shpërndarja e bizneseve sipas veprimtarisë 8
2.4. Struktura e pronësisë së kompanive në industri 9
2.5. Struktura ligjore dhe vitet e përvojës së kompanive në industri 9
2.6. Mosha, gjinia dhe përkatësia etnike e pronarit të kompanisë 10

3. Kontributi dhe rezultatet nga kompanitë/industria 12
3.1. Gjithsej kostot e lëndës së parë, mallrave të ndërmjetme dhe kostot tjera të furnizimit të kontributeve 12
3.2. Rezultatet: vlera dhe struktura e prodhimeve 14
3.3. Niveli i shfrytëzimit të kapacitetit 16
3.4. Qarkullimi dhe kanalet lokale dhe ndërkombëtare të shpërndarjes/shitjeve 16

4. Eksportet: Bilanci i industrisë, vlera në nivel të kompanisë dhe pengesat për eksport 19
4.1. Bilanci tregtar i industrisë 19
4.2. Veprimtaria e eksportit sipas madhësisë së kompanisë 19
4.3. Pengesat në eksport 21

5.Punësimi në kompani/industri, kapacitetet njerëzore dhe zhvillimi i fuqisë punëtore 23
5.1. Struktura e punësimit sipas gjinisë, moshës dhe kualifikimit shkollorë 23
5.2. Perceptimet e bizneseve për nivelin e shkathtësive të fuqisë punëtore 25
5.3. Zhvillimi i fuqisë punëtore 26

6. Asetet, investimet dhe risitë në kompani/industri 27
6.1. Gjithsej asetet e kompanisë 27
6.2. Gjithsej investimet, risitë dhe ndryshimet organizative në kompani 28
6.3. Perceptimet e bizneseve për zhvillimin e produkteve/shërbimeve të reja dhe mbrojtjen e pronës industriale në Kosovë 28

7.Mjedisi i biznesit 30
7.1. Masat stimuluese për bizneset që veprojnë në këtë industri 30
7.2. Perceptimet e biznesit për nivelin e tatimeve në Kosovë 30
7.3. Perceptimet e bizneseve për performancën e ATK-së dhe Doganat e Kosovës 31
7.4. Perceptimet e bizneseve lidhur me koston e financave në Kosovë 31

8. Konkluza 33

Shtojcat 35
Shtojca 1: Lista e institucioneve relevante për sektorin e drurit 35
Shtojca 2: Korniza ligjore që ka të bëjë me sektorin e drurit 35
Shtojca 3: Lista e tatimeve, detyrimeve doganore dhe kontributeve pensionale 36
Shtojca 4: Lista e licencave dhe dokumenteve për sektorin e drurit 37
Shtojca 5: Rregulloret tregtare dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë 37
Shtojca 6: Ligji i punës dhe rregulloret e tjera 38
Shtojca 7: Prona industriale dhe patentat në Kosovë 38
Shtojca 8: Kostoja e financimit në industrinë e drurit dhe kërkesat për kredi 39

Lista e shkurtesave

PAT	Preferencat Autonome Tregtare
B2B	Biznesi për biznesin
CEFTA	Marrëveshja për Tregti të Lirë për Evropën Qendrore
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës
AKS	Agjencia Kosovare e Standardizimit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
TVSH	Tatim në Vlerë të Shtuar

1. Hyrje

Profili i këtij sektori ofron informata për situatën aktuale të sektorit të drurit në Kosovë, me fokus më të madh në aktivitetet e përpunimit të drurit. Raporti përbëhet nga këto pjesë: një pasqyrë e të dhënave bazike për sektorin; gjetjet nga informatat e kompanive për eksportet dhe importet në nivel të sektorit dhe kompanive; të dhënat e punësimit, asetet e kompanive, investimet dhe inovacionet; dhe në fund, gjetjet lidhur me perceptimet e bizneseve për pengesat për zhvillim të biznesit. Periudha e mbuluar është viti 2012 dhe për disa nga çështjet kryesore janë mbledhur edhe të dhëna për vitin 2011.

Profili i këtij sektori mbështetet në burime zyrtare të të dhënave dhe një anketë të ndërmarrësisë të kryer nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) për qëllime të këtij raporti. Karakteristikat e përgjithshme të sektorit, duke përfshirë madhësinë dhe përbërjen e sektorit bazohen në të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK). Bilanci tregtar i këtij sektori është bazuar në Doganat e Kosovës. Treguesit e kompanive për karakteristikat dhe performancën e sektorit bazohen në të dhënat e anketës të grumbulluara nga UNDP gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2013. Mostra e përzgjedhur për këtë anketë përbëhet nga 204 nga 595 kompani aktive në bazën e të dhënave Administratën Tatimore të Kosovës me kode SIC 2010, 2020, 2030, 2040, 2051, 3611, 3612, 3613, dhe 3614 deri më 2012. Është me rëndësi të theksohet se disa prej 595 kompanive janë biznese mikro që i takojnë kodit të veprimtarisë 2030 'Prodhues të zdrukthëtarisë dhe mobilerisë' por të cilët janë përjashtuar nga kuadri i mostrës. Arsyeshmëria për këtë përjashtim qëndron në faktin që këto biznese janë zakonisht punëtori të vogla kryesisht për kryerjen e riparimeve dhe jo të prodhimit, i cili edhe ishte fokusi parësor në këtë studim. Duke pasur parasysh që ky sektor përgjithësisht përbëhet nga kompani të nivelit mikro, anketa ka bërë përpjekje t'i mbulojë të gjitha ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe të mëdha, si dhe një mostër të rastësishme të ndërmarrjeve mikro. Pas përjashtimit të ndërmarrjeve në kodin 2030, mostra përfundimisht përbëhej nga 165 prej 293 ndërmarrjeve mikro dhe 39 nga 45 të ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të mëdha.

Sektori i drurit konsiderohet të jetë një nga sektorët strategjikë të Kosovës me potencial të madh për zhvillim. Sipas ATK-së, sektori i drurit përbën 2% të bizneseve aktive dhe 1% të punonjësve të regjistruar. Shumica e bizneseve janë ndërmarrje mikro, por gjithashtu ekziston edhe një numër i bizneseve të mesme. Aktiviteti kryesor i bizneseve të sektorit të drurit është prodhimi i kuzhinave dhe mobileve. Ferizaj është rajoni me përqendrimin më të madh të kompanive të sektorit të drurit.

Më 2012, qarkullimi mesatar i bizneseve mikro ishte €41,000. Për bizneset e vogla ai ishte €150,000, ndërsa qarkullimi për bizneset e mesme ishte mesatarisht €1.5 milion. Më 2012, numri mesatar i punonjësve për kompani në sektorin e drurit ishte 15, që shënonte rritje të konsiderueshme nga 7 punonjës për kompani më 2011. Në vitin 2012, 91% të kompanive shitnin produktet fundore në nivel lokal dhe kjo përbënte 95% të gjithsej shitjeve vendore.

Më shumë se 90% të bizneseve të anketuara kanë raportuar se kanë në pronësi të tyre makineritë dhe pajisjet, ndërsa 80% kanë në pronësi tokë dhe ndërtesa. Krahasuar me vitin 2011, vlera e ndërtesave më 2012 është rritur për 22% dhe vlera e makinerisë për 77%. Më 2012, kompanitë në sektorin e drurit kanë raportuar se kanë shfrytëzuar rreth dy të tretat e kapacitetit të tyre, që është po ashtu rritje nga 2011 në 2012.

Gjetjet nga anketa tregojnë që 95% të kompanive prodhojnë produkte fundore, 18% produkte të ndërmjetme dhe 10% lëndë të parë. Mesatarisht, 76% të gjithsej shpenzimeve janë nga blerjet e lëndës së parë dhe mallrave të ndërmjetme, ndërsa pagat përbëjnë rreth 16% të gjithsej shpenzimeve. Shumica e kompanive importojnë produktet e ndërmjetme dhe lëndën e parë; pastaj ato përpunohen më tutje në produkte fundore.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), nga 2010 deri më 2011, vëllimi i eksportit në sektorin e drurit është rritur për 11%; për 19% nga 2011 deri 2012; dhe bazuar në vlerësimet për 2013, eksportet në sektorin e drurit do të rriten për 50%. Anketa ka konstatuar se rreth 15% të bizneseve të sektorit të drurit eksportojnë në tregjet në rajonin e Ballkanit dhe në Evropë në tërësi.

Të gjitha kompanitë e anketuara të madhësisë së mesme kanë pohuar se eksportojnë produktet e tyre. Këtë e bëjnë një e treta e kompanive të vogla dhe, siç mund të pritej, një përqindje shumë më e vogël e kompanive mikro. Produktet kryesore të eksportuara janë dritaret, dyert, kuzhinat dhe mobilet.

Nga 2011 deri 2012, vëllimi i eksportit në nivel të kompanive është rritur për mesatarisht 23%. Eksportuesit kanë deklaruar se pengesa më e madhe me të cilën ata përballen gjatë eksportimit është kostoja e lartë e transportimit dhe pengesa e dytë më e madhe është mundësia e kufizuar për të krijuar lidhje me rrjete ndërkombëtare të bizneseve.

Rreth 15% e kompanive në sektorin e drurit kanë përvetësuar risi në veprimtarinë e tyre, të cilat kryesisht përfshijnë aplikimin e teknologjive dhe softuerit të ri. Përveç kësaj, rreth 90% të kompanive kanë patentë të regjistruar dhe mendojnë se procedurat për të nuk janë tejet problematike.

Bazuar në të dhënat për vitin 2011 dhe 2012, të gjithë treguesit në nivel të kompanive tregojnë rritje në sektorin e drurit: ndryshimet pozitive në qarkullim, vlerë të prodhimit, shifra të punësimit dhe eksporte. Bizneset në sektorin e drurit investojnë edhe në produkte të reja edhe në zhvillim të fuqisë punëtore. Bizneset nuk i shohin tatimet si shumë të larta, por ende vazhdon të jetë e pranishme një pengesë e madhe për zhvillimin e biznesit: normat e larta të kamatës në kreditë bankare.

2. Të dhëna bazike për sektorin e drurit

Nga viti 2010 deri më 2013, janë regjistruar rreth 400 kompani të reja në sektorin e drurit, mesatarisht 100 biznese të reja të regjistruara në vit (Figura 1). Prodhimi i kuzhinave dhe mobileve është aktiviteti më i regjistruar --50% të bizneseve të reja të regjistruara në sektor (Figura 1).

Figura 1: *Numri i bizneseve të regjistruara sipas veprimtarisë*



Burimi: ATK, 2013

2.1. Shpërndarja e kompanive sipas madhësisë

Sipas ATK-së, në fund të vitit 2012, nga gjithsej 21,615 bizneset e regjistruara në Kosovë, 565 kanë vepruar në sektorin e drurit. Përpunimi i drurit kryesisht dominohet nga bizneset mikro dhe të vogla (Figura 2).

Figura 2: *Shpërndarja e bizneseve sipas madhësisë*



Burimi: ATK, 2013

2.2. Shpërndarja rajonale e kompanive në sektor

Ndarja e të dhënave sipas rajoneve tregon se një e katërta e bizneseve është e përqëndruar në rajonin e Ferizajt—(141 biznese nga 565), 19% janë në Prishtinë, 18% në Gjilan, 17% në Prizren ndërsa 22% të tjera veprojnë në Pejë, Gjakovë dhe Mitrovicë (Figura 3).

Figura 3: *Shpërndarja e bizneseve sipas rajoneve*



Burimi: ATK , 2013

2.3. Shpërndarja e bizneseve sipas veprimtarisë

Sipas bazës së të dhënave të ATK-së, 44% e bizneseve prodhojnë kuzhina, mobile dhe produkte të tjera të drurit (35% prodhojnë kuzhina dhe mobile dhe 9% prodhojnë produkte të tjera të drurit, Figura 4). Më shumë se 40% të kompanive të sektorit të drurit prodhojnë materiale zdrukthëtarie për ndërtim dhe mobilieri, ndërsa që sharrat dhe palosjet e drurit, si dhe impregnimi i drurit janë veprimtari më pak të pranishme tek kompanitë e sektorit të drurit.

Figura 4: *Shpërndarja e bizneseve sipas veprimtarisë kryesore*



Burimi: ATK , 2013

2.4. Struktura e pronësisë së kompanive në industri

Shumica e kompanive (91%) në industrinë e sektorit të drurit kanë vetëm një pronar. Në 2.5% të rasteve, pronari kryesor i kompanisë zotëronte më pak se 50% të aksioneve. Tek të gjitha mostrat e përzgjedhura, përpjesa mesatare e pronarit kryesor të kompanive është 91% (Tabela 1).

Tabela 1: *Struktura e pronësisë*

Pjesa e pronarit kryesor	% e kompanive
Nën 50%	2.5%
50%	2.0%
Ndërmjet 50-100%	4.9%
100%	90.7%
Mesatarja e të gjithave	**90.7%**

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Kompanitë në sektorin e drurit janë pothuajse tërësisht në pronësi vendore. Vetëm një nga 204 kompanitë e intervistuara ka raportuar pronarë të huaj në pronësi të 75% të kompanisë. Rreth 13.2% të kompanive kanë raportuar se kanë pronësi të kompanive të tjera private (Tabela 2).

Tabela 2: *Pronësia sipas kompanive*

	% të kompanive	Pjesa mesatare
Pronësia e kompanive private	13.2%	94.6%
Pronësia e kompanive të huaja	0.5% (1 kompani)	75%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

2.5. Struktura ligjore dhe vitet e përvojës së kompanive në industri

Rezultatet e anketës zbulojnë se 95% të kompanive janë biznese individuale, 2% janë të regjistruara si partneritete të përgjithshme, dhe 3% janë të regjistruara si shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (Figura 5).

Figura 5: *Statusi ligjor i kompanive (në %)*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

2.6. Mosha, gjinia dhe përkatësia etnike e pronarit të kompanisë

Mosha mesatare e pronarëve të kompanive është 43 vjeç. Gjysma e të gjithë pronarëve janë më të rinj se 40 vjeç, ndërsa më i riu ishte 24. Nga kompanitë e anketuara, 95% të pronarëve ishin shqiptarë, 3.4% turq, 1% serbë dhe pjesa tjetër ishin boshnjakë, goranë dhe nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian (Figura 6). Sektori i drurit është kryesisht i dominuar nga meshkujt.

Figura 6: *Pronësia sipas përkatësisë etnike*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Pronarët kryesorë të kompanive kanë raportuar se kanë kryer mesatarisht 12 vite shkollim, që është e barasvlershme me shkollimin e mesëm. Më saktësisht, 76.5% të pronarëve kanë të kryer shkollimin e mesëm dhe pjesa tjetër kanë mbi 12 vite shkollim. Nga radhët e pronarëve kryesorë, niveli mesatar i shkollimit të grave është më i lartë (13 vite) krahasuar me mesataren e përgjithshme.

Rubrika 1: Profili i një biznesi të suksesshëm që vepron në Kosovë

Me vendndodhje në pjesën veriore të Kosovës, Binni është një nga kompanitë më të mëdha të prodhimit të drurit në Kosovë. Është biznes familjar që ka filluar veprimtarinë me një punonjës qysh më 1989 ndërsa tani numëron rreth 80 punonjës. Pesë vëllezër janë pronarë dhe udhëheqës të kësaj kompanie, disa prej të cilëve janë kthyer nga Evropa dhe e kanë shndërruar Binnin në histori suksesi.

Në fillim, kapitali i kompanisë ishte modest, por kompania ia doli të rritet shumë shpejtë. Në veçanti, Binni realizoi një shkallë të rritjes prej 60% gjatë tri viteve të fundit. Sipas pronarëve të kompanisë, kjo rritje mund t'i atribuohet imazhit të mirë që kompania ka ndërtuar përmes produkteve cilësore të saj dhe zotimit për kënaqësi të konsumatorëve. Kompania është prodhues specialitetesh, në kuptimin e asaj që prodhojnë vetëm produkte të veçanta me porosi.

Ndonëse normat e kamatës konsiderohen të jenë të larta krahasuar me standardet ndërkombëtare, Binni konsideron se kreditë që i kanë marrë nga bankat e Kosovës kanë qenë çelësi i rritjes së kompanisë, posaçërisht duke marrë parasysh kapitalin e kufizuar fillestar.

Stafi i kualifikuar si dhe përdorimi i teknologjive bashkëkohore gjithashtu janë konsideruar si kontribuues të mëdhenj të suksesit të kompanisë. Së fundmi, kompania ka instaluar një makinë të re të lyerjes me llambë UV e cila ende nuk është e pranishme në kompanitë tjera në rajon. Përveç kësaj, Binni shfrytëzon lëndë të parë të importuar kryesisht nga Gjermania, Kroacia, Italia dhe shtetet tjera evropiane.

Përkundër faktit që vepron në një sektor mjaft konkurrues, zhvillimi i kompanisë Binni ka qenë pothuajse tërësisht i bazuar në kërkesën vendore.

Kompania megjithatë eksporton në Zvicër, por këto eksporte përbejnë përqindje të ulët të gjithsej të hyrave të përgjithshme të Binnit. Tregu i Kosovës vazhdon të jetë tregu më i rëndësishëm dhe më premtues për kompaninë. Duke pasur parasysh teknologjinë moderne, cilësinë e lëndës së parë dhe përkushtimin për kënaqësi të konsumatorëve, Binni është i bindur se do të shohë zhvillim të mëtejmë.

Pronarët e kompanisë kanë theksuar se shkalla e tatimeve në Kosovë është shumë e arsyeshme, posaçërisht krahasuar me ato që i kanë përjetuar gjatë veprimtarisë në Gjermani. Një pengesë që ata e kanë vërejtur ka të bëjë me tarifat doganore dhe TVSH-në që duhet të paguhet në importe para vjeljes së të hyrave nga to. Është përmendur edhe mundësia e hapjes së depos doganore si opsion që mund ta ndjekin për t'i ikur pagesës së doganës para vjeljes së të hyrave. Procedurat e eksportimit konsiderohen të jenë shumë të thjeshta dhe duke pasur parasysh se eksportet e tyre i nënshtrohen taksave të ulëta kur importojnë tek shtetet e huaja (7% për Zvicër), kompania ka preferuar t'i zgjerojë eksportet e saj. Megjithatë, identifikimi dhe kontakti me blerësit potencialë nga tregjet ndërkombëtare vazhdon të jetë sfidë për Binnin.

3. Kontributi dhe rezultatet[1] nga kompanitë/industria

3.1. Gjithsej kostot e lëndës së parë, mallrave të ndërmjetme dhe kostot tjera të furnizimit të kontributeve

Kompanitë e anketuara kanë raportuar se mesatarisht 75% të kostove të tyre janë si pasojë e blerjes së lëndës së parë dhe mallrave të ndërmjetme, ndërsa që pagat përbëjnë rreth 16% të gjithsej kostove mesatarisht (Tabela 3). Përpjesa e kostos së pagave në gjithsej kostot është më e ulëta për kompanitë mikro. Përpjesa e kostos së pagave është më e larta në kompanitë që prodhojnë pllaka rimeso, kompensatë dhe tabela.

Tabela 3: *Kostot mesatare mujore të kontributit sipas madhësisë së kompanisë (në €)*

	Lënda e parë dhe produktet e ndërmjetme	Kostot e pagave	Energji elektrike	Ujë	Derivate	Të tjera
Mikro (1-9 punonjës)	9,431	1,357	176	11	423	167
Të vogla (10-49 punonjës)	18,211	6,324	885	24	1,226	967
Të mesme (50-249 punonjës)	136,667	28,050	2,300	113	2,025	850
Gjithsej	**13,220**	**2,756**	**337**	**15**	**594**	**387**

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Origjina e lëndës së parë dhe produkteve të ndërmjetme është mjaft e shumëllojshme (Tabela 4). Rreth një e treta e kompanive në sektorin e drurit përdorin lëndën e tyre të parë dhe mallra të ndërmjetme, ndërsa 68% të kompanive furnizohen nga tregjet vendore. Me lëndë të parë dhe mallra të ndërmjetme të importuara kryesisht furnizohen nga tregtarë vendorë (në 38% të rasteve), dhe më pak blihen nga tregtarë të huaj apo drejtpërsëdrejti nga prodhuesit (17% dhe 13% të kompanive përkatësisht). Kjo mund të sugjerojë që kompanitë vendore luajnë një rol të rëndësishëm të furnizimit për kompanitë e drurit të angazhuara në prodhim. Kjo gjithashtu mund të nënkuptojë se ekziston një zinxhir i zhvilluar i furnizimit për sektorin e përpunimit të drurit në Kosovë (d.m.th. kompanitë në sektorin e prodhimit të drurit mund të gjejnë lëndë të parë nga furnizuesit që janë me vendndodhje brenda Kosovës). Është interesante të theksohet se kompanitë që furnizojnë lëndën e tyre të parë dhe mallrat e ndërmjetme janë në gjendje të mbulojnë mesatarisht 76% të nevojave të tyre. Përveç kësaj, tregtarët vendorë janë konsideruar si të rëndësishëm për kompanitë që përdorin lëndë të parë të importuar dhe mallra të ndërmjetme, meqë gati dy të tretat e nevojave të tyre plotësohen nga të lartcekurat.

1 Në anglisht: Input and output

Tabela 4: *Burimet e furnizimit të lëndës së parë dhe mallrave të ndërmjetme (vendore kundrejt ndërkombëtare)*

	Furnizimi i lëndës së parë dhe mallrave të ndërmjetme	
	% e kompanive	Pjesëmarrja mesatare e lëndës së parë dhe mallrave të ndërmjetme
Nga tregu vendor		
Prodhuar nga kompania	34%	76%
Nga furnitorët vendorë	68%	33%
Importuar		
Nga tregtarët vendorë	38%	63%
Nga tregtarët e huaj	17%	52%
Drejtpërdrejti importuar nga prodhuesi	13%	31%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Siç ilustrohet në tabelën më sipër, shumica e kompanive importojnë lëndë të parë dhe materiale të ndërmjetme të cilat më tej përpunohen në produkte fundore. Vetëm 20% të kompanive importojnë produkte të gatshme fundore. Për sa i përket origjinës së importeve, rreth një e pesta e kompanive importojnë nga Turqia; 18% nga Mali i Zi; dhe 13% e kompanive nga Gjermania. Shtetet tjera nga të cilat importojnë kompanitë janë Norvegjia, Hungaria, Bullgaria, Bosnja dhe Hercegovina, e kështu me radhë.

3.2. Rezultatet: vlera dhe struktura e prodhimeve

Vlera e raportuar e rezultateve të kompanive është më e madhe se €25,000 për afro 50% të bizneseve. Vlera e prodhimit vjetor e bizneseve që prodhojnë kuzhina dhe mobile është €2.5-5 milionë. Kompanitë që kanë raportuar vlera më të larta të prodhimit kanë rritur të gjitha aktivitetet gjatë periudhës 2011-2012 (Figura 7 dhe Figura 7a). Mesatarisht, vlera e prodhimit më 2011 është vlerësuar të jetë €90,000 për kompani, ndërsa vlera më 2012 ishte €107,000 mesatarisht. Kjo përbën rritje prej 18% në vlerën e prodhimit mesatar përgjatë dy viteve.

Figura 7: *Vlera e prodhimit vjetor*

A: *Vlera e prodhimit në vitin 2012 (në €)*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013[2]

2 Llogaritjet/përqindjet përfshijnë vetëm bizneset që janë përgjigjur në këtë pyetje.

B: *Vlera e prodhimit në vitin 2011 (në €)*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013[3]

Gjetjet kanë treguar se 95% e kompanive të anketuara prodhojnë produkte fundore, 18% prodhojnë produkte të ndërmjetme dhe 10% lëndë të parë. Kompanitë që prodhojnë produkte fundore kanë raportuar se ato përbëjnë mesatarisht 94% të prodhimit të tyre total, gjersa është raportuar se produktet e ndërmjetme dhe lënda e parë përbëjnë një të tretën dhe 15%, përkatësisht, të gjithsej prodhimit të kompanive që i prodhojnë ato. Figura 8 tregon që 77% të kompanive të anketuara prodhojnë vetëm produkte fundore, 3% prodhojnë produkte të ndërmjetme, 1% prodhojnë vetëm lëndë të parë dhe pjesa tjetër prej 19% prodhojnë një kombinim të këtyre produkteve (Figure 8).

Figura 8: *Përqindja e kompanive të angazhuara në prodhimin e vetëm një lloji të mallrave*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

3 Llogaritjet/përqindjet përfshijnë vetëm bizneset që janë përgjigjur në këtë pyetje.

3.3. Niveli i shfrytëzimit të kapacitetit

Kompanitë në sektorin e drurit kanë raportuar se shfrytëzojnë rreth dy të tretat e kapacitetit të tyre dhe se shfrytëzimi i kapacitetit është rritur më 2012 (Figura 9). Gjithashtu më 2012, përqindja e kompanive që kanë realizuar shfrytëzim të plotë të kapacitetit të tyre ishte 21%, që është pesë pikë të përqindjes më ulët sesa më 2011. Numri i kompanive që kanë raportuar se shfrytëzojnë më pak se 50% të kapacitetit të tyre është ulur për 6 pikë të përqindjes ndërmjet periudhës 2011 dhe 2012, nga 25% në 19%.

Figura 9: *Shfrytëzimet e kapacitetit, 2011 dhe 2012*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

3.4. Qarkullimi dhe kanalet lokale dhe ndërkombëtare të shpërndarjes/shitjeve

Më 2012, gati një e treta e bizneseve kanë pasur një qarkullim mesatar vjetor prej mbi €50,000 (Figura 10). Qarkullimi vjetor i bizneseve që prodhojnë kuzhina dhe mobile arriti një mesatare prej €5 milionë. Qarkullimi mesatar i sektorit është rritur për 7% nga 2011 deri më 2012. Kjo rritje ishte më e larta tek bizneset që prodhojnë mobile për zyra dhe dyqane. Shitja mesatare e bizneseve mikro ishte €41,000, €150,000 për ato të vogla dhe €1.5 milionë për bizneset e mesme.

Figura 10: *Shitjet sipas veprimtarisë kryesore, 2012*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Kështu, kompanitë që operojnë në sektorin e drurit kryesisht shesin në tregun vendor, ndërsa më pak se 15% të kompanive kanë pasur shitje jashtë vendit më 2011 dhe 2012 (Tabela 5). Më shumë se 80% të kompanive shesin produktet e tyre vetëm në Kosovë dhe më pak se një për qind vjelin të hyra vetëm nga shitjet ndërkombëtare. Kjo mund të sugjerojë që Kosova përfaqëson një treg të rëndësishëm për kompanitë në sektorin e drurit. Duke i parë shitjet mesatare sipas tregut, mund të vërehet se 95% e qarkullimit inkasohet nga tregjet vendore për kompanitë që kanë deklaruar shitje në Kosovë (91%). Ndonëse një numër i vogël i kompanive janë aktive në tregjet ndërkombëtare, ato kanë raportuar se një e pesta e shitjeve të tyre vinin nga eksportet.

Tabela 5: *Shitjet vendore kundrejt atyre ndërkombëtare*

	% të kompanive	
	2011	**2012**
Shitjet vendore	96%	99.5%
Shitjet në tregun ndërkombëtar	12%	13.3%
Vetëm në tregun vendor	**84%**	**83%**
Vetëm në tregun ndërkombëtar	**0.5%**	**0.5%**
	2011	**2012**
Mesatarja e shitjeve vendore	95%	95%
Mesatarja e shitjeve ndërkombëtare	20%	20%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Ndonëse vetëm një numër i vogël i kompanive aktualisht eksportojnë, afro një e treta e tyre planifikojnë një gjë të tillë në të ardhmen. Rreth 77% të kompanive shesin produktet e tyre tek shitësit me pakicë dhe 66% të tyre i shesin produktet drejtpërsëdrejti tek konsumatorët fundorë. Vetëm 15% të kompanive i shesin produktet e tyre kompanive të tjera për përpunim të mëtejmë.

Figura 11: *Kanalet e shitjes/shpërndarjes*

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Në kuptim të vëllimi të shitur, për kompanitë që deklarojnë se shesin drejtpërsëdrejti tek konsumatorët, qarkullimi mesatar i inkasuar nga ky kanal është 64%, qarkullimi mesatar i inkasuar nga shitësit me pakicë është 52%, ndërsa nga shpërndarësit/shitësit me pakicë 41% (Figura 12).

Figura 12: *Përpjesa e shitjeve sipas llojit të blerësve*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

4. Eksportet: Bilanci i industrisë, vlera në nivel të kompanisë dhe pengesat për eksport

4.1. Bilanci tregtar i industrisë

Nga 2010 deri më 2011, vëllimi i eksportit të produkteve të drurit është rritur për 11%; nga 2011 deri 2012 për 19%; dhe bazuar në vlerësimet e përafërta për 2013, eksportet do të rriten për 50% (Figura 13). Mesatarisht, vëllimi i importuar i produkteve të prodhuara të drurit ka rënë gjatë periudhës 2010-2012. Si rrjedhojë, bilanci tregtar është përmirësuar gjatë kësaj periudhe.

Figura 13: *Bilanci tregtar i produkteve të prodhuara të drurit (mijëra €)*



Burimi: Doganat e Kosovës, 2013

4.2. Veprimtaria e eksportit sipas madhësisë së kompanisë

Siç u përmend më lart, rezultatet nga anketa tregojnë se 13.3% të bizneseve të përpunimit të drurit eksportojnë produktet e tyre. Ndarja e këtyre të dhënave sipas madhësisë së kompanisë tregon se të gjitha kompanitë e vogla dhe të mesme eksportojnë, një e treta e kompanive të vogla eksporton dhe, si do mund të pritej, një përqindje shumë më e vogël e kompanive mikro eksportojnë (Figura 14).

Figura 14: *Veprimtaria e eksportit sipas madhësisë së kompanisë*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Shumica e produkteve të eksportuara janë dritare dhe dyer, kuzhina dhe mobile. Mesatarisht, vlera e eksporteve është rritur për 23% nga 2011 deri 2012 (Figura 15). Ndonëse kjo mesatare ndryshonte ndërmjet €50,000 dhe €60,000, një numër më i vogël i kompanive kanë eksportuar më shumë se €200,000 në vit.

Figura 15: *Vëllimi i eksportit sipas veprimtarisë së biznesit (në €)*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Në terma relativë, rritja e vëllimit të eksportit ishte më e larta për kuzhinat dhe mobilet. Destinacionet kryesore për produktet e përpunimit të drurit ishin Shqipëria, Mali i Zi dhe Zvicra. Destinacionet për eksportet e ardhshme besohen të jenë kryesisht shtetet Evropiane siç janë Gjermania, Austria dhe Zvicra. Përsëri, siç është theksuar më lartë, ne mesin e bizneseve që eksportojnë, 20% e qarkullimit të tyre vije nga kjo veprimtari. Viti 2009 shënoi një rritje të konsiderueshme në numrin e bizneseve që eksportojnë (Figura 16). Një pjesë më e vogël e kompanive kanë nisur veprimtarinë e tyre të eksportit më 2010 dhe kjo mund të jetë e lidhur me krizën globale. Megjithatë, pas vitit 2010, gjithnjë e më shumë kompani po i bashkohen tregjeve ndërkombëtare.

Figura 16: *Viti kur kompanitë kanë filluar të eksportojnë (% të gjithsej të anketuarve)*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

4.3. Pengesat në eksport

Nga kompanitë që eksportojnë është kërkuar që ta japin vlerësimin e tyre të ndikimit të disa pengesave me të cilat janë përball gjatë eksportimit. Shkalla e vlerësimit ishte nga 0-10 ku 0 nënkupton se çështja e listuar nuk është pengesë fare dhe 10 se është pengesë e rëndë. Gjithashtu, pyetja është ndarë në pengesën e parë dhe të dytë për nga madhësia. Gjetjet tregojnë se kompanitë që eksportojnë konsiderojnë se kostot e larta të transportimit janë pengesa kryesore për eksportim, vijuar nga procedurat doganore (Tabela 6). Gati një e treta e kompanive kanë identifikuar pengesat që lidhen me vizat, detyrimet doganore dhe marrëdhëniet me Serbinë. Një gjetje interesante është se gati 40% të kompanive nuk mund ta emëronin një pengesë me të cilën janë përballë gjatë aktiviteteve të tyre të eksportit.

Kur janë pyetur lidhur me pengesën e dytë për nga rëndësia, gati dy të tretat kanë deklaruar se nuk dinë nëse pengesa kryesore lidhej me kontrollin e cilësisë, fitosanitarinë dhe çështjet me viza.

Tabela 6: *Pengesat e hasura gjatë eksportit (vetëm kompanitë eksportuese)*

	Pengesa e parë kryesore (% e kompanive)
Kostot e transportit	17.9%
Procedurat doganore	7.1%
Mundësi të kufizuara për të krijuar lidhje me rrjetet ndërkombëtare të biznes-eve	3.6%
Arsye të tjera (viza; detyrime doganore; marrëdhëniet me Serbinë)	32.1%
Nuk e di	39.3%

	Pengesa e dytë më e madhe (% e kompanive)
Efikasiteti i administratës doganore në shtetet në tranzicion	3.7%
Efikasiteti i doganierëve	3.7%
Marrëdhëniet politike me shtetin importues	3.7%
Mundësi të kufizuara për të krijuar lidhje me rrjetet ndërkombëtare të biznes-eve	7.4%
Të tjera (kontrolli i cilësisë; fitosanitari, viza)	18.5%
Nuk e di	62.9%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Nga kompanitë e anketuara gjithashtu është kërkuar që ta notojnë rëndësinë e pengesave të caktuara (shkalla: 0 – nuk është pengesë, deri në 10 – pengesë e madhe), dhe pengesat më të mëdha për eksport janë thënë të jenë efikasiteti i dobët i doganave në shtetet transit dhe ato importuese, kostot e larta të garancive bankare dhe marrëdhëniet politike me shtetet importuese (Tabela 7).

Tabela 7: *Pengesat për eksport, shkalla mesatare (vetëm kompanitë që eksportojnë)*

	Shkalla mesatare
Efikasiteti i doganave në shtetet transit dhe ato importuese	6.04
Kostot e larta të garancive bankare	5.77
Mundësi të kufizuara për të krijuar lidhje me rrjetet ndërkombëtare të bizneseve	5.73
Marrëdhëniet politike me shtetin importues	5.54
Efikasiteti i dobët i zyrtarëve të shpedicionit	5.23
Procedurat doganore	5.19
Mungesa e financave	4.92
Kostot e transportit	4.62
Standardet ndërkombëtare të cilësisë (sanitari, fitosanitari dhe standarde të tjera ndërkombëtare)	4.08
Infrastruktura në shtetin transit apo importues	3.77

Burimi: Anketa e UNDP, 201

Pengesa shtesë për eksport ishin ato që kishin të bënin me mungesën e certifikatave të sigurimit të cilësisë, menaxhimi joefikas, mungesa e gatishmërisë nga pronarët e bizneseve për ta shtrirë prodhimin dhe furnizimi i pasigurt me energji elektrike.

Është me rëndësi të theksohet se kostoja e transportit dhe koha dhe kostot (e transaksionit) për plotësimin e procedurave doganore janë duke u trajtuar nga Qeveria e Kosovës. Kostoja e transportit pritet të ulet me përfundimin e Autostradës R7 e cila do të lidhë Kosovën me Shqipërinë dhe Serbinë dhe Autostradën R6 me Maqedoninë – ndërtimi i së cilës pritet të fillojë më 2014. Në anën tjetër, korniza rregullative për tregti ndërkufitare është reformuar kohëve të fundit dhe numri i dokumenteve të duhura për eksport është ulur gradualisht, duke ulur koston e tregtisë për 20% .[4]

4 Faqja e internetit e MTI, nxjerrë nga http://www.mti-ks.org/sq/Reformat-e-te-berit-biznes

5. Punësimi në kompani/industri, kapacitetet njerëzore dhe zhvillimi i fuqisë punëtore

5.1. Struktura e punësimit sipas gjinisë, moshës dhe kualifikimit shkollorë

Sipas ATK-së, sektori i drurit përbënte 1% të punonjësve të Kosovës më 2012. Gjithashtu, gjetjet e anketës kanë treguar se numri mesatar i punonjësve për kompani ishte 15 më 2012, që është rritje e konsiderueshme nga 7 punonjës për kompani më 2011. Mesatarisht, punësimi është rritur për 112% nga 2011 në 2012 (Figura 17). Kompanitë që prodhojnë mobile dhe kuzhina janë ndër ato që kanë përjetuar rritjen më të lartë në kuptim të punësimit, 118%. Në nivel të kompanive më 2012 punësimi i grave është rritur për 30% ndërsa shikuar nga numri total i grave të punësuara, ky numër është rritur për 200% (nga 122 në 354).

Figura 17: *Rritja e kompanive (shkalla e rritjes sipas numrit të punonjësve)*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Për afro 70% të punonjësve, shkolla e mesme ishte niveli më i lartë i shkollimit të arritur. Përderisa 11% të punonjësve kanë raportuar se kanë kryer shkollim të lartë, respondentët e anketës kanë pohuar se vetëm 1% e punonjësve të tyre kanë kryer shkollim profesional, gjersa 14% të tyre kanë përfunduar shkollimin fillor (Figura 18).

Figura 18: *Shkollimi i përfunduar i punonjësve*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Sektori i përpunimit të drurit është i dominuar nga burrat. Vetëm një e katërta e kompanive kanë gra të punësuara. Kështu, numri mesatar i burrave të punësuar për kompani është më i lartë sesa ai i grave (2 gra dhe 7 burra më 2011 dhe 5 gra dhe 7 burra më 2012); megjithatë, kjo mospërputhje ka rënë nga viti 2011 në 2012 (Figura 19).

Figure 19: *Përbërja gjinore e punonjësve*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Ky sektor karakterizohet me punësim të punonjësve të moshës së mesme: mesatarisht, 70% të punonjësve i takojnë grupmoshës prej 25 deri 50 vjeç (Figura 20). Megjithatë, duket se sektori i drurit është gjithashtu atraktiv për të rinjtë, meqë rinia përbën 40% të bazës së punonjësve në këtë sektor.

Figura 20: *Struktura e moshës së punonjësve*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Për më tepër, ky sektor është kontribuues i rëndësishëm i punësimit të qëndrueshëm: pothuajse të gjitha kompanitë në sektorin e drurit kanë punonjës me orar të plotë, të cilët përbëjnë 90% të gjithsej punësimit në këtë sektor. Vetëm 3% të kompanive punësojnë personel me gjysmë orari, të cilët përbëjnë vetëm 27% të gjithsej punonjësve në këto kompani. Më pak se 15% të kompanive angazhojnë punonjës sezonalë, që paraqesin 15% të punonjësve të këtyre kompanive.

Afro 10% të kompanive punësojnë komunitete joshqiptare, dhe në ato kompani, numri mesatar i tyre është rreth 2. Përpjesa më e madhe e punonjësve joshqiptarë përbëhet nga romë, ashkali, egjiptianë dhe turq.

5.2. Perceptimet e bizneseve për nivelin e shkathtësive të fuqisë punëtore

Gjetjet e anketës sugjerojnë se kompanitë e shohin mungesën e punonjësve të shkathët si shqetësim më të madh sesa kostot e punës të këtyre punonjësve të kualifikuar (Figura 21). Siç mund të shihet nga figura më poshtë, mungesa e punonjësve me shkollim/shkathtësi adekuate konsiderohet të jetë problem madhor për 46% të kompanive të anketuara, vijuar nga 42% që kanë pohuar se ka mungesë të të diplomuarve universitarë për sektorin e drurit dhe 40% që kanë raportuar se ka problem me mungesën e punonjësve me shkollim profesional të lidhur me sektorin. Gati një e katërta e kompanive të sektorit të drurit kanë deklaruar se të diplomuarit nga universitetet dhe shkollat profesionale janë të shtrenjtë dhe 35% kanë pohuar se punonjësit e kualifikuar janë të shtrenjtë.

Figura 21 [5]**:** *Oferta dhe kostoja e punonjësve të shkathët*

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

5 Shënim: Përgjigjet ishin Po, Jo, në një masë dhe Nuk e di. Në këtë diagram është raportuar vetëm përqindja e kompanive që janë përgjigjur me Po.

5.3. Zhvillimi i fuqisë punëtore

Rezultatet e anketës tregojnë se gati një e pesta e kompanive të sektorit të drurit ofrojnë trajnime për punonjësit e tyre. Tre çerek (75%) të kompanive të mesme, 100% të kompanive të mëdha kanë raportuar se ofrojnë trajnime, gjersa këtë e bëjnë vetëm 13.4% dhe 37.1% të kompanive të vogla dhe mikro, përkatësisht.

Duke pasur parasysh se një numër më i madh i punonjësve në sektorin e drurit janë burra, një përqindje më e madhe e kompanive ka pohuar se trajnimet janë ofruar për burrat, jo për gratë. Vetëm 13% e grave janë trajnuar krahasuar me 21% të punonjësve burra. Shumica e trajnimeve janë organizuar në vend të punës dhe ishin me fokus në rritjen e shkathtësive të punonjësve në prodhim. Megjithatë, vetëm 5 nga 204 kompanitë e anketuara në sektorin e drurit kanë raportuar se kanë investuar në përmirësimin e shkathtësive menaxhuese dhe të prezantimit për punonjësit e tyre.

6. Asetet, investimet dhe risitë në kompani/industri

6.1. Gjithsej asetet e kompanisë

Shumica e aseteve të kompanive janë në pronësi të bizneseve të anketuara, gjersa vetëm një pjesë e vogël e tyre merren me qira: 93% e bizneseve kanë në pronësi makinerinë dhe pajisjet; 80% të bizneseve kanë në pronësi tokë dhe ndërtesa (Figura 22). Për vitin 2012, gjithsej vlera e aseteve të bizneseve të anketuara është vlerësuar të jetë €46 milionë: vlera mesatare e tokës ishte €120,000; e ndërtesave €180,000 dhe e makinerisë dhe pajisjeve €115,000. Kur i krahasojmë këto shifra me vitin 2011, të dhënat nga anketa tregojnë se vlera e ndërtesave është rritur për 22% dhe ajo e makinerisë për 77% më 2012. Megjithatë, vlera e tokës është vlerësuar të jetë më se 20% më e ulët, por kjo mund t'i atribuohet ndryshimeve në tregun e tokës.

Figura 22: *Posedimi i aseteve*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Ndërtesat përbëjnë një përpjesë më të madhe të gjithsej aseteve për bizneset e mesme krahasuar me kompanitë e madhësive të tjera (Figura 23). Vlera mesatare e ndërtesave për kompanitë e mesme është €1.5 milionë, ndërsa vlera e makinerisë është vlerësuar të jetë €625,000. Në kompanitë mikro, toka përbën 44% të aseteve ndërsa ndërtesat dhe makineria dhe pajisjet kontribuojnë barabartë për 56% të mbetura të vlerës së aseteve. Në kompanitë e vogla, ndërtesat përbëjnë përqindjen më të madhe të aseteve (38%) vijuar nga makineria dhe pajisjet (34%) dhe kontributi më i vogël në vlerën e aseteve vjen nga toka me 29%.

Figura 23: *Vlera e aseteve sipas madhësisë së kompanive*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

6.2. Gjithsej investimet, risitë dhe ndryshimet organizative në kompani

Më shumë se 20% të kompanive në sektorin e drurit kanë investuar në produkte të reja më 2012, dhe gjithsej mesatarja e të gjitha investimeve në kompanitë që kanë investuar përbënte €90,000. Remitancat janë burim i rëndësishëm për investime në sektorin e drurit: 30% e kompanive që kanë investuar në një produkt të ri kanë përdorur remitancat si burim financiar. Shuma mesatare e remitancave të futura në kompani ishte €50,000. Rreth 15% të kompanive në sektorin e drurit kanë ndërmarrë disa aktivitete të reja, të cilat kryesisht përfshijnë blerje të teknologjisë bashkëkohore dhe aplikim të softuerëve të ri. Afro 10% e kompanive kanë kryer strategji inovative të marketingut, kryesisht lidhur me dizajnin e një produkti të ri. Vetëm 4% të kompanive kanë aplikuar ndryshime të reja organizative.

Përpjesa mesatare e intensitetit të kapitalit (makineria dhe pajisjet/qarkullimi) është 2.6.[6] Intensiteti kapital është më i ulët tek bizneset e mesme (1.73) sesa për bizneset mikro (2.7) dhe ato të vogla (2.2).

6.3. Perceptimet e bizneseve për zhvillimin e produkteve/shërbimeve të reja dhe mbrojtjen e pronës industriale në Kosovë

Disa kompani të përpunimit të drurit mendojnë se shkalla ekzistuese e mbrojtjes së të drejtave pronësore në Kosovë ka ndikim negativ në sektor, qoftë për sa i përket zhvillimit të produkteve/shërbimeve të reja (21% të kompanive) qoftë aktiviteteve të transferimit të kompanive ndërkombëtare (10% të kompanive) (Tabela 8). Kopjimi i produkteve dhe konkurrenca e padrejtë konsiderohen si pasojat kryesore të zbatimit të dobët të të drejtave pronësore.

6 Variabla fillestare intervale e 'qarkullimi' është transformuar në variabël të vazhdueshme duke caktuar vlera mesatare për secilin interval.

Tabela 8: *Perceptimet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut*

A ka ndikim niveli aktual i mbrojtjes së të drejtave pronësore tek kompanitë e sektorit të drurit?	% e kompanive
Jo	38%
Po, i parandalon kompanitë që të zhvillojnë produkte/shërbime	21%
Po, i parandalon kompanitë në transferimin e veprimtarive të kompanive ndërkombëtare	10%
Nuk e di	31%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Të dhënat e anketës tregojnë se 87% e kompanive kanë patentë të regjistruar dhe 86% të tyre i kanë nxjerrë ato që nga vitit 2000. Për më tepër, kompanitë nuk mendojnë se procedurat për regjistrimin e patentave janë të vështira (Tabela 9).

Tabela 9: *Regjistrimet e patentave dhe perceptimet për procedurat për regjistrim*

	% e kompanive
Kompania ka patentë të regjistruar	87%
Vështirësitë në regjistrimin e licencave pengojnë zhvillimin e biznesit	8%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

7. Mjedisi i biznesit

7.1. Masat stimuluese për bizneset që veprojnë në këtë industri

- Nuk ka detyrime doganore në importe të teknologjisë.
- Ekziston një mundësi për bizneset, përmes autorizimit të depove doganore, të pezullojnë pagesën e TVSH-së për lëndën e parë deri kur të jenë krijuar mallrat fundore, dhe në rastet kur mallrat e importuara shkojnë në rieksport nuk paguhen fare taksa.
- Mundësia për të shtyrë pagesën e TVSH-së në importet e pajisjeve dhe makinerive të caktuara deri në 6 muaj (për të lejuar që pajisjet dhe makineritë të kenë hyrë në operim para se të paguhet TVSH-ja në koston e tyre).
- Autorizimi për eksportin e përkohshëm, importin dhe përpunim të jashtëm: kjo mundëson bizneset që të shtyjnë pagesën e taksave për një kohë apo në rast se mallrat janë ri-eksportuar, nuk paguhen fare tatime.

7.2. Perceptimet e biznesit për nivelin e tatimeve në Kosovë

Gati gjysma e të gjitha kompanive që operojnë në sektorin e drurit kanë deklaruar se niveli i tatimeve në Kosovë është 'mesatar' d.m.th. nuk është i lartë dhe nuk është i ulët (Figura 24). Rreth një e treta konsiderojnë se tatimet janë 'të larta' dhe 12% mendojnë se ato janë 'shumë të larta'. Një gjetje interesante është se 8% e kompanive i shohin tatimet si 'të ulëta' apo 'shumë të ulëta' (Figura 24).

Figura 24: *Perceptimet e bizneseve për nivelin e tatimeve në Kosovë*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Në mesin e atyre kompanive që konsiderojnë që niveli i tatimeve është 'i lartë', shumica kanë theksuar se ky nivel shihet si i lartë për shkak të marzhës së ulët të fitimit që aplikojnë shumica e kompanive. TVSH-ja është shënuar të jetë një nga tatimet e larta.

7.3. Perceptimet e bizneseve për performancën e ATK-së dhe Doganat e Kosovës

Në përgjithësi, kompanitë në këtë sektor i shohin administratat e tatimeve dhe doganave si relativisht efikase (Figura 25). Rreth 80% e kompanive kanë theksuar se ATK vepron me një nivel 'mesatar' të efikasitetit, se është ose 'efikas' ose 'shumë efikas'. Rreth 70% të kompanive të anketuara ndajnë të njëjtin perceptim për sa i përket efikasitetit të Doganave të Kosovës.

Figura 25: *Perceptimet e biznesit për performancën e administratës tatimore dhe doganës*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

7.4. Perceptimet e bizneseve lidhur me koston e financave në Kosovë

Më shumë se gjysma e kompanive të përpunimit të drurit kanë pohuar se sigurimi i financimit është 'i vështirë' apo 'shumë i vështirë', dhe vetëm 8% kanë deklaruar se ai është 'i lehtë' apo 'shumë i lehtë' (Figura 26).

Figura 26: *Perceptimet e bizneseve lidhur me lehtësinë e sigurimit të financave në këtë sektor*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Kostoja e financimit konsiderohet si mjaft e lartë nga kompanitë. Më shumë se gjysma e bizneseve kanë deklaruar se normat e kamatës janë 'të larta' apo 'shumë të larta', gjersa vetëm 15% kanë thënë se normat e kamatës janë 'të ulëta' apo 'të shumë të ulëta' (Figura 27).

Figura 27: *Perceptimet e bizneseve lidhur me normën e kamatës*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

8. Konkluza

Profili i këtij sektori prezanton të dhëna në nivel të sektorit dhe të kompanive. Të dhënat e nivelit të sektorit janë siguruar nga Administrata Tatimore dhe Doganat e Kosovës. Të dhënat në nivel të kompanive janë bazuar në anketën e UNDP-së 2013 që përfshinte 204 kompani, nga të cilat 165 ishin kompani mikro dhe 39 kompani të vogla dhe të mesme. Gjetjet kryesore të profilit të këtij sektori janë paraqitur në vijim.

Rreth 92% të kompanive në sektorin e drurit janë të nivelit mikro, 7.8% janë të vogla dhe vetëm 0.5% janë ndërmarrje të mesme. Aktiviteti kryesor i bizneseve të sektorit të drurit është prodhimi i kuzhinave dhe mobileve. Një e katërta e kompanive të sektorit të drurit janë me vendndodhje në rajonin e Ferizajt. Shumica dërmuese e kompanive janë në pronësi të shqiptarëve dhe nga pronarë meshkuj.

Mesatarisht 75% të gjithsej kostove të kompanive janë si pasojë e blerjes së lëndës së parë dhe mallrave të ndërmjetme, ndërsa pagat përbëjnë mesatarisht rreth 16% të gjithsej kostove. Rreth një e treta e kompanive në sektorin e drurit përdorin lëndën e tyre të parë dhe mallrat e ndërmjetme, dhe 68% e kompanive furnizohen nga tregjet vendore. Për sa i përket prejardhjes së importeve, rreth një e pesta e kompanive importojnë nga Turqia, 18% nga Mali i Zi dhe 13% e kompanive importojnë nga Gjermania.

Vlera e raportuar e prodhimit të kompanive është më e madhe se €25,000 për afro 50% të bizneseve. Vlera e prodhimit vjetor të bizneseve që prodhojnë kuzhina dhe mobile është €2.5-5 milionë. Mesatarisht, vlera e prodhimit më 2011 është vlerësuar të jetë €90,000 për kompani, ndërsa vlera më 2012 ishte €107,000 mesatarisht. Kjo përbën rritje prej 18% në vlerën e prodhimit mesatar përgjatë dy viteve. Gjetjet nga anketa tregojnë që 95% të kompanive prodhojnë produkte fundore, 18% produkte të ndërmjetme dhe 10% lëndë të parë.

Qarkullimi mesatar i sektorit është rritur për 7% nga 2011 deri më 2012. Kjo rritje ishte më e larta tek bizneset që prodhojnë mobile për zyra dhe dyqane. Shitjet mesatare të bizneseve mikro ishin €41,000, €150,000 për ato të vogla dhe €1.5 milionë për bizneset e mesme. Kompanitë që veprojnë në sektorin e drurit kryesisht shesin në tregun vendor, ndërsa më pak se 15% të kompanive kanë pasur shitje jashtë vendit më 2011 dhe 2012. Ndonëse një numër i vogël i kompanive janë aktive në tregjet ndërkombëtare, ato kanë raportuar se një e pesta e shitjeve të tyre vijnë nga eksportet.

Të dhënat nga Doganat e Kosovës tregojnë se nga 2010 në 2011, vëllimi i eksportit në sektorin e drurit është rritur për 11%; nga 2011 deri 2012 për 19%; dhe bazuar në vlerësimet për 2013, eksportet në sektorin e drurit do të rriten për 50%. Të dhënat nga anketa tregojnë se 13.3% të bizneseve të përpunimit të drurit eksportojnë produktet e tyre. Produktet kryesore të eksportuara janë dritaret, dyert, kuzhinat dhe mobilet. Sipas të dhënave nga anketa, destinacionet kryesore për produktet e drurit ishin Shqipëria, Mali i Zi dhe Zvicra.

Destinacionet për eksportet e ardhshme besohen të jenë kryesisht shtetet Evropiane siç janë Gjermania, Austria dhe Zvicra. Pengesat më të mëdha në eksporte janë theksuar të jenë efikasiteti i dobët i doganave në shtetet transit dhe ato të importit, kostot e larta të garancive bankare dhe marrëdhëniet politike me shtetet e importit.

Sipas ATK-së, sektori i drurit përfshinte 1% të punonjësve më 2012. Gjetjet e anketës kanë treguar se numri mesatar i punonjësve për kompani ishte 15 më 2012, që është rritje e konsiderueshme nga 7 punonjës për kompani më 2011. Për afro 70% të punonjësve, shkolla e mesme ishte niveli më i lartë i shkollimit të arritur. Sektori i drurit është kryesisht sektori i dominuar nga meshkujt. Vetëm një e katërta e kompanive kanë të punësuara gra. Gjetjet e anketës sugjerojnë se kompanitë e shohin mungesën e punonjësve të shkathët si shqetësim më të madh sesa kostot e punës të këtyre punonjësve të kualifikuar. Rezultatet e anketës tregojnë se gati një e pesta e kompanive të sektorit të drurit sigurojnë trajnime për punonjësit e tyre.

Shumica e aseteve të kompanive janë në pronësi të bizneseve të anketuara, gjersa vetëm një pjesë e vogël e tyre merren me qira: 93% e bizneseve kanë në pronësi makinerinë dhe pajisjet; 80% të bizneseve kanë në pronësi tokë dhe ndërtesa. Për vitin 2012, gjithsej vlera e aseteve të bizneseve të anketuara është vlerësuar të jetë €46 milionë: vlera mesatare e tokës ishte €120,000; e ndërtesave €180,000 dhe e makinerisë dhe pajisjeve €115,000. Përpjesa mesatare e intensitetit të kapitalit (makineria dhe pajisjet/qarkullimi) është 2.6.[7] Intensiteti kapital është më i ulët tek bizneset e mesme (1.73) sesa për bizneset mikro (2.7) dhe ato të vogla (2.2).

Më shumë se 20% e kompanive në sektorin e drurit kanë investuar në produkte të reja më 2012. Afro 10% e kompanive kanë zbatuar strategji inovative të marketingut, kryesisht lidhur me dizajnin e një produkti të ri. Vetëm 4% të kompanive kanë aplikuar ndryshime të reja organizative.

Afro gjysma e të gjitha kompanive që veprojnë në sektorin e drurit kanë theksuar se niveli i tatimeve në Kosovë është 'mesatar', d.m.th. jo i lartë dhe jo i ulët. Rreth 80% e kompanive kanë theksuar se ATK vepron me një nivel 'mesatar' të efikasitetit, se është ose 'efikas' ose 'shumë efikas'. Rreth 70% të kompanive të anketuara ndajnë të njëjtin perceptim për sa i përket efikasitetit të Doganave të Kosovës. Për sa i përket qasjes në financim dhe kostos së saj, më shumë se gjysma e kompanive të drurit kanë theksuar se sigurimi i financimit është 'i vështirë' apo 'shumë i vështirë' dhe më shumë se gjysma e bizneseve kanë theksuar se normat e kamatës janë 'të larta' apo 'shumë të larta'.

7 Variabla fillestare intervale e 'qarkullimi' është transformuar në variabël të vazhdueshme duke caktuar vlera mesatare për secilin interval.

Shtojcat

Shtojca 1: Lista e institucioneve relevante për sektorin e drurit

- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë: regjistrimi i biznesit (ARBK); informata për çështje tregtare dhe çështje të tjera të lidhura me biznese
- Ministria e Financave: informata lidhur me politikat tatimore
- Autoriteti i Administratës Tatimore: pagesa e tatimeve
- One-stop-shopet" komunale: burime të informatave për biznese dhe ofrimi i shërbimeve konsulente
- Doganat e Kosovës: informata për detyrimet dhe procedurat doganore
- Agjencia për Promovimin e Investimeve: informata për investitorët e huaj
- Oda Ekonomike e Kosovës: burim i informatave për rrjetet e bizneseve, panaire, misione tregtare, takime mes bizneseve (B2B), trajnime
- Shoqata e Përpunuesve të Drurit: rrjete afariste, panaire, misione tregtare, avokim për sektorin

Shtojca 2: Korniza ligjore që ka të bëjë me sektorin e drurit

- Ligji nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare
- Ligji nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme
- Ligji nr. 02/L-33 për investimet e huaja
- Ligji nr. 02/L-5 për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
- Ligji nr. 04-L-047 për masat mbrojtëse në importe
- Ligji nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare
- Ligji nr. 04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme
- Ligji nr. 03/L –229 për mbrojtjen e konkurrencës
- Ligji nr. 03/L-031 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02-L-5 për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Doganës dhe Akcizës nr. 03/L-109 04/L-099
- Ligji për administratën tatimore dhe procedurat 2004/48
- Ligji për tatimin në vlerën e shtuar 03/L-114
- Ligji për tatimin në të ardhura personale 03/L-161
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për tatimin në të ardhurat personale nr. 03/L-161
- Ligji për tatimin në të ardhurat e korporatës 03/L-162
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-162 për tatimin në të ardhura të korporatës 04/L-103
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L – 204 për tatimin në pronë 04/L-100
- Ligji për tatimin në pronën e paluajtshme 03/L-204
- Rregullore nr. 01/2013 për kërkesat teknike për pllakat e drurit
- Ligji nr. 04/L-048 për tregtinë e jashtme
- Rregullore për masat e tregtisë autonome
- Udhëzimi administrative nr. 14 /2013 për regjistrimin, licencimin dhe procedurat e zbatimit administrativ
- Kodi doganor dhe i akcizave në Kosovë: Kodi nr. 03/L-109

Shtojca 3: Lista e tatimeve, detyrimeve doganore dhe kontributeve pensionale

Lloji	Norma dhe përshkrimi
Tatimi në të ardhura personale: **Ligi nr. 03/L-161** **Ligji nr. 04/L-104**	Ky lloj tatimi aplikohet në të ardhura nga paga, biznesi, qiraja, interesi, pasuria e patundshme etj. Normat tatimore të tatimit në të ardhura personale nga paga janë normal progresive duke u bazuar në lartësinë e pagës së fituar dhe njëherë norma më të ulëta në regjion dhe në shtetet e BE-së. Normat tatimore janë: 0% deri në €960/vit; 4% mbi €960 dhe €3,000/vit; 8% mes të €3,001 dhe €5,400/vit; 0% mbi €5,400/vit. Ndryshuar më 2011: nëntë për qind (9%) të të ardhurave bruto nga shërbimet, aktivitetet profesionale, artizanale, argëtuese dhe të ngjashme për çdo tremujor, por jo më pa se tridhjeteshtatë pikë pesë (37.5)€ për tremujor.
Kodi i veçantë tatimore për zhvlerësimin	Në bazë të nenit 15 të Ligjit për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatës (nr. 03/L- 162), shuma e lejuar për zbritje të zhvlerësimit për periudhën tatimore do të përcaktohet me aplikimin e përqindjeve të poshtëshënuara për llogaritë kapitale përmes metodës së balancimit të zbritjes: ■ Kategoria 1: Ndërtesat; pesë për qind (5%) ■ Kategoria 2: Automjetet dhe pajisjet për zyre; njëzet për qind (20%) ■ Kategoria 3: Makineritë dhe automjetet për transport të rëndë; pesëmbëdhjetë për qind (15%)
Tatimi në korporata **Ligji nr. 03/L- 162**	Varësisht nga të ardhurat vjetore, subjektet juridike vendore dhe përfaqësitë e përhershme të subjekteve juridike të huaja tatohen si në vijim: Të ardhura vjetore €0-€5,000 =€375/tremujor Të ardhura vjetore €5,001-€50,000=3-10% të të ardhurave Të ardhura vjetore €50,001=10% të fitimit
Tatimi në vlerën e shtuar	Tatimi në vlerën e shtuar (Ligji nr. 03/L- 146) aplikohet për të gjithë importuesit dhe bizneset me qarkullim vjetor më të madh se €50,000. Norma e TVSH-së është 16% dhe aplikohet në të gjitha mallrat dhe shërbimet, me përjashtim të disa produkteve bujqësore dhe kapitale (në të cilët TVSH është 0%). Eksportuesit marrin rimbursim të plotë të TVSH-së për mallrat e eksportuara.
Tatimet në prona	Tatimi në pronë është futur më 2003 dhe inkasohet në nivel lokal nga ana e administratës komunale. Kuvendi Komunal i çdo komune përcakton normat e tatimit në pronë në bazë vjetore. Normat tatimore ndryshojnë nga 0.05% dhe 1% të vlerës së pronës në treg.
Kontributet pensionale	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës është përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e llogarive individuale për kursimin e pensioneve. Kjo taksë detyron të punësuarin dhe punëdhënësin që të kontribuojnë në financimin e pensionit të punonjësit në masë prej 5% nga paga e punëmarrësit dhe 5% nga punëdhënësi.

Shtojca 4: Lista e licencave dhe dokumenteve për sektorin e drurit

Lejet dhe certifikatat

- Certifikata e biznesit
- Regjistrimi i TVSH-së
- Regjistrimi i punonjësve për skemën e pensioneve me ATK-në
- Vërtetimi i mbrojtjes nga zjarri
- Vërtetimi për ujin
- Leja e ndërtimit
- Lidhja në energji elektrike

Dokumentet e importit

- Dokumenti unik administrativ (d.m.th. deklarata doganore)
- Fatura komerciale
- Certifikata e prejardhjes (për shtetet me të cilat Kosova ka tregti të lirë apo marrëveshje të tjera që mbulojnë përjashtimet bazuar në rregullat e prejardhjes).

Dokumentet e eksportit

- Dokumenti unik administrativ (d.m.th. deklarata doganore);
- Fatura komerciale

Shtojca 5: Rregulloret tregtare dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë

- **Kosova** është pjesë e marrëveshjes CEFTA që nga viti 2007 dhe gjithashtu përfiton nga Preferencat Autonome Tregtare (PAT) me BE-në, marrëveshja për tregti pa detyrime doganore me SHBA-në dhe lidhjet tregtare me Japoninë, Norvegjinë dhe Turqinë.
- **CEFTA:** Të zotuar për të krijuar parime për zhvillim të qëndrueshëm të një ekonomie të pastër tregu që në fazat e hershme të zhvillimit, Qeveria e Kosovës ka punuar drejt mundësimit të lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve përgjatë tërë kufijve të vendit. Si rezultat i kësaj, Kosova aktualisht gëzon tregti të lirë në kuadër të Marrëveshjes së Evropës Qendrore për Tregti të Lirë – CEFTA – duke iu mundësuar prodhuesve të saj t'i qasen tregut rajonal prej 28 milion konsumatorëve, pa asnjë obligim doganor. Në vitin 2012, eksportet totale me anëtarët e CEFTA-s kanë qenë €102.6 milion dhe importet €844.6 milion.
- **Preferencat Autonome Tregtare (PAT):** Gjithashtu, Kosova është përfituese e Masave Autonome Tregtare te vendosura nga BE-ja me Rezolutën e Këshillit (2007/2000). Në vitin 2012 gjithsej eksportet për ne SHBA ishin €107.4 milionë. Ne vitin 2011 eksportet për ne SHBA ishin €0,25 milionë dhe importet €46.9 milionë.
- **Japoni dhe Norvegji:** Lidhjet tregtare dhe kufizimet sasiore dhe cilësore me Japoninë dhe Norvegjinë mbeten ne aplikueshme vetëm për një numër te kufizuar te mallrave. Importet me Norvegjinë ne vitin 2012 ishin 3.69 milionë.
- **Turqi:** Kosova gjithashtu ka marrëveshje të tregtisë së lirë me Turqinë, që do të hyjë në fuqi pas ratifikimit të saj nga Parlamenti i Turqisë.

Shtojca 6: Ligji i punës dhe rregulloret e tjera

- Kosova ka një treg fleksibil të punës me normë të ulët tatimore dhe kufizime të pakta në punësimin e punonjësve. Sistemi i normës së tatimit në të ardhura personale është sistemi progresiv tatimor me normë prej 0-10 %. Përveç kësaj, vetëm një kontribut pensional prej 5% nga paga e plotë paguhet nga punëdhënësi (gjersa 5% të tjera nga paga e punonjësit). Që nga viti 2011, Kosova ka aplikuar një pagë minimale prej €170, apo €130 për individët nën moshën 35 vjeçe. Që nga viti 2011, marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me ligjin e punës (nr. 03/L-212) i cili merr parasysh Konventat e ONP, legjislacionin e BE-së dhe parimet themelore të tregut të lirë dhe ekonomisë së lirë. Që nga viti 2013, shëndeti dhe siguria në punë rregullohen me ligjin për shëndetin dhe sigurinë në punë (nr. 04/L-161). Duke i pasur parasysh rreziqet e mëdha të shëndetit dhe sigurisë të cilat mund t'i prekin punonjësit e sektorit të drurit, ligji për shëndetin dhe sigurinë në punë është shumë i rëndësishëm.

Shtojca 7: Prona industriale dhe patentat në Kosovë

- Të drejtat e pronësisë industriale regjistrohen dhe administrohen nga Agjencia për Pronësi Industriale që vepron në kuadër të Ministrisë për Tregti dhe Industri.

- Markat tregtare: janë të rregulluara me ligjin për markat tregtare (nr. 04/L-026). Pronari i markës së regjistruar tregtare, pas regjistrimit, do të ketë të drejta ekskluzive lidhur me mallrat apo/dhe shërbimet e mbuluara nga regjistrimi. Mbajtësi i markës tregtare ka të drejtë të parandaloj palët e treta të përdorin markën pa lejen e tij. Në veçanti, këto të drejta përfshijnë: shfrytëzimin e markës tregtare, autorizimin e një personi tjetër për shfrytëzimin e markës tregtare ose për të shfrytëzuar mjete juridike për shkelje të markës tregtare. Marka tregtare është e regjistruar për një periudhë prej 10 viteve dhe mund të rinovohet për një kohë të pakufizuar.

- Dizajni industrial: rregullohet me Ligjin mbi Dizajnin Industrial (Ligji Nr.04/L-028) dhe dizajni është i mbrojtur me ligj deri në masën që është një risi dhe ka një karakter të veçantë. Mbrojtja e dizajnit industrial zgjatë pesë vite dhe mund të zgjatet maksimalisht për 25 vite.

- Patentat: rregullohen me Ligjin mbi Patentat (Ligji Nr. 04/L-029). Një shpikje do të jetë e patentueshme nëse ajo është e re, përfshin një hap inventiv, dhe është e zbatueshme në industri. E drejta e patentës jepet për kohëzgjatje prej 20 viteve.

- Kompanitë e intervistuara konsiderojnë se procedurat e patentimit janë të thjeshta.

Shtojca 8: Kostoja e financimit në industrinë e drurit dhe kërkesat për kredi

Që nga tetori i vitit 2013, norma efektive e kamatës në kreditë e reja është 11.72% (Banka Qendrore e Kosovës, 2013). Norma efektive e kamatës në kreditë investuese (me maturitet deri në pesë vite) është me ulët në 10.21%. Është me rëndësi të theksohet se Kosova ka normën më të ulët të kredive të këqija në rajon.

Kërkesat për kredi

- Certifikatat e regjistrimit të biznesit, e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Certifikata e TVSH-së dhe dokumenti 'Informata për biznesin'
- Të dhënat financiare për së paku 12 muaj
- Lista e inventarit dhe pajisjeve të kompanisë, një kopje e matjes së pronave dhe "lista e pronësisë" së hipotekës.

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRISË

www.mti-ks.org